



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS  
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS  
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

**Numri:** KSC-CC-2020-11

**Vendosi:** **Dhoma e Specializuar e Gjykatës Kushtetuese**  
Gjykatës Vidar Stensland, kryegjykatës  
Gjykatës Antonio Balsamo  
Gjykatës Roumen Nenkov

**Administratore:** Fidelma Donlon

**Data:** 26 nëntor 2020

**Gjuha:** Anglishte

**Titulli i dosjes:** Referim lidhur me ndryshimet e propozuara të Kushtetutës së Kosovës

**Klasifikimi:** Publik

---

**Aktgjykim mbi Referimin e amendamenteve të propozuara të  
Kushtetutës së Kosovës**

---

**Kryetares së Kuvendit të Kosovës**  
Vjosa Osmani - Sadriu

## Dhoma e Specializuar e Gjykatës Kushtetuese,

me përbërjen:

Vidar Stensland, kryegjykatës

Antonio Balsamo, gjykatës

Roumen Nenkov, gjykatës

pas kuvendimeve të zhvilluara nga distanca shqipton aktgjykimin e mëposhtëm.

### I. PROCEDURA

1. Më 24 gusht 2020, Presidenti i atëhershëm i Kosovës propozoi amendamentet nr. 26 dhe nr. 27 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës ("Kushtetuta"), në veçanti të paragrafëve (13) dhe (14) të nenit 162 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar (që përmendet gjithashtu si "ZPS").<sup>1</sup>

2. Më 18 shtator 2020, në përputhje me nenet 144(3) dhe 162(3) të Kushtetutës, Kryetarja e Kuvendit të Kosovës ia përcolli amendamentet kushtetuese të propozuara Kryetares së Dhomave të Specializuara për vlerësim paraprak të tyre nga kjo Dhomë ("Referimi").<sup>2</sup>

3. Më 5 tetor 2020, në përputhje me rregullën 15(2) të Rregullores së Punës të Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese ("Rregullorja e Punës"), Dhoma<sup>3</sup>

---

<sup>1</sup> KSC-CC-2020-11, F00001, A01 Propozim-amendamentet e Kushtetutës, publike, 24 gusht 2020 (protokolluar më 21 shtator 2020).

<sup>2</sup> KSC-CC-2020-11, F00001, Shkresë e Kryetares së Kuvendit të Kosovës, publike, 18 shtator 2020, me shtojcën A01 (protokolluar më 21 shtator 2020).

<sup>3</sup> Në lidhje me caktimin e panelit të Gjykatës Kushtetuese, shih KSC-CC-2020-11, F00002, Vendim për caktimin e panelit të Gjykatës Kushtetuese, publik, 22 shtator 2020. Në lidhje me gjuhën e punës së kësaj procedure, shih KSC-CC-2020-11, F00003, Vendim për gjuhën e punës, publik, 24 shtator 2020. Në lidhje me vendin e zhvillimit të kësaj procedure, shih KSC-CC-2019-06, F00002, Vendim mbi vendin e zhvillimit të procedurave para Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese, publik, 22 janar 2019; KSC-CC-2019-06, F00001, Kërkesë për ndryshimin e vendit të zhvillimit të procedurës në lidhje me referimet e parashtruara në përputhje me nenin 49 të Ligjit, publike, 18 janar 2019.

njoftoi disa autoritete të caktuara për Referimin, me mundësinë që të paraqisnin parashtrimet e tyre, në qoftë se dëshironin, në lidhje me pranueshmërinë dhe themelësinë e Referimit. Dhoma i kërkoi edhe Presidentit të Kosovës që të dorëzonte informacion të caktuar.<sup>4</sup>

4. Më 7 tetor 2020, në përputhje me rregullën 15(2) të Rregullores së Punës, Dhoma miratoi kërkesën e ZPS-së për leje për paraqitjen e parashtrimeve me shkrim në lidhje me pranueshmërinë dhe themelësinë e Referimit.<sup>5</sup>

5. Më 16 dhe 19 tetor 2020, Avokati i Popullit i Dhomave të Specializuara dhe ZPS-ja dorëzuan parashtrimet e tyre me shkrim,<sup>6</sup> kurse Presidenti i Kosovës dorëzoi informacionin në lidhje me amendamentet e propozuara.<sup>7</sup>

6. Më 20 tetor 2020, Dhoma miratoi kërkesat<sup>8</sup> e Përfaqësuesit të Lartë të Bashkimit Evropian për Politikë të Jashtme dhe të Sigurisë/Zëvendës-presidentit të Komisionit Evropian (“Përfaqësuesi i Lartë”) dhe të Shefit të Misionit të Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë (EULEX) (përkatësisht “BE” dhe “Misioni EULEX Kosova”) për zgjatjen e afatit për dorëzimin e parashtrimeve me shkrim deri më 2 nëntor 2020.<sup>9</sup>

---

<sup>4</sup> KSC-CC-2020-11, F00004, Vendim për njoftimin e referimit dhe kërkesë për informacion, publik, 5 tetor 2020.

<sup>5</sup> KSC-CC-2020-11, F00006, Vendim mbi kërkesën e ZPS-së për leje për paraqitjen e parashtrimeve, publik, 7 tetor 2020; KSC-CC-2020-11, F00005, Kërkesë e Prokurorisë për leje për paraqitjen e parashtrimeve, publike, 6 tetor 2020.

<sup>6</sup> KSC-CC-2020-11, F00007, Parashtrime të Avokatit të Popullit në lidhje me Referimin, publike, 16 tetor 2020; KSC-CC-2020-11, F00008, Parashtrimet e Prokurorisë në lidhje me amendamentet e propozuara të Kushtetutës së Kosovës, publike, 19 tetor 2020.

<sup>7</sup> KSC-CC-2020-11, F00009, Parashtrime të Presidentit të Republikës së Kosovës, publike, 16 tetor 2020 (protokolluar më 19 tetor 2020).

<sup>8</sup> KSC-CC-2020-11, F00011, Kërkesë për zgjatjen e afatit, parashtruar në emër të Përfaqësuesit të Lartë të Bashkimit për Politikë të Jashtme dhe të Sigurisë/Zëvendës-presidentit të Komisionit Evropian, publike, 19 tetor 2020; KSC-CC-2020-11, F00010, Kërkesë e Shefit të Misionit EULEX Kosova për zgjatjen e afatit, publike, 19 tetor 2020.

<sup>9</sup> KSC-CC-2020-11, F00012, Vendim mbi kërkesën për zgjatjen e afatit për dorëzimin e parashtrimeve me shkrim, publik, 20 tetor 2020.

7. Përfaqësuesi i Lartë dhe Shefi i Misionit EULEX Kosova dorëzuan parashtrimet e tyre me shkrim më 30 tetor dhe 2 nëntor 2020.<sup>10</sup>
8. Kryeministri i Kosovës, i cili ishte njoftuar gjithashtu nga Dhoma për Referimin, nuk paraqiti parashtrime me shkrim.

## II. HISTORIKU NË LIDHJE ME FAKTET

### A. RAPORTI I KËSHILLIT TË EVROPËS

9. Më 25 janar 2011, Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës miratoi një raport që përmbante pretendime për trajtim çnjerëzor dhe vrasje të personave gjatë dhe pas konfliktit të armatosur në Kosovë ("Raporti"),<sup>11</sup> dhe bëri thirrje për hetimin e atyre pretendimeve.<sup>12</sup>

10. Në shtator 2011 u formua Task Forca Hetimore Speciale ("TFHS") për të kryer hetim penal të pavarur të pretendimeve të paraqitura në Raport. Autoriteti ligjor i TFHS-së buronte nga vendimi i përbashkët i Këshillit 2008/124/CFSP i 4 shkurtit 2008, që kishte themeluar Misionin EULEX Kosova.<sup>13</sup>

### B. SHKËMBIMI I LETRAVE I VITIT 2012

11. Më 4 shtator 2012, Presidentja e Kosovës dhe Përfaqësuesja e Lartë shkëmbyen letra në lidhje me mandatin e Misionit EULEX Kosova. Në letrën e saj drejtuar

<sup>10</sup> KSC-CC-2020-11, F00013, Parashtrim me shkrim nga Përfaqësuesi i Lartë i Bashkimit për Politikën e Jashtme dhe të Sigurisë mbi pranueshmërinë e Referimit, publik, 30 tetor 2020; KSC-CC-2020-11, F00014, Parashtrim me shkrim nga Shefi i Misionit EULEX Kosova, publik, 2 nëntor 2020.

<sup>11</sup> Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës, Raporti Doc. 12462, Trajtimi çnjerëzor i personave dhe trafikimi i paligjshëm i organeve njerëzore në Kosovë, 7 janar 2011.

<sup>12</sup> Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës, Rezoluta 1782(2011), Hetimi i pretendimeve për trajtim çnjerëzor të personave dhe trafikim të paligjshëm të organeve njerëzore në Kosovë, 25 janar 2011.

<sup>13</sup> Vendim i Përbashkët i Këshillit 2008/124/CFSP i 4 shkurtit 2008 mbi Misionin e Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë, EULEX Kosova. Është ndryshuar 15 herë. Ndryshimet e fundit u bënë me Vendimin e Këshillit (CFSP) 2020/792 të 11 qershorit 2020, me të cilin mandati i Misionit EULEX Kosova zgjatet deri më 14 qershor 2021.

Përfaqësueses së Lartë, Presidentja e Kosovës konfirmoi se TFHS-ja do të vazhdonte punën deri në njoftimin e Kosovës nga Këshilli i Bashkimit Evropian (“Këshilli”) për përmbylljen e hetimeve ose procedurave që janë rrjedhojë e tyre.

12. Më 7 shtator 2012, me Ligjin nr. 04/L-148, Kuvendi i Kosovës ratifikoi Shkëmbimin e Letrave të përmendur më lart si marrëveshje ndërkombëtare mes Kosovës dhe BE-së. Neni 1(2) i Ligjit përcakton ratifikimin e marrëveshjes ndërkombëtare në tërësi.<sup>14</sup>

#### C. SHKËMBIMI I LETRAVE I VITIT 2014

13. Më 14 prill 2014, Presidentja e Kosovës dhe Përfaqësuesja e Lartë shkëmbyen letra. Në letrën e saj drejtuar Përfaqësueses së lartë, Presidentja e Kosovës deklaroi si vijon:

[...]

Nëse hetimi nga SITF-ja rezulton me aktakuzë dhe procedura gjyqësore, duhet siguruar një mjedis të përshtatshëm për administrimin e duhur të drejtësisë. Në pajtim me këtë, një gjykatë e specializuar brenda sistemit gjyqësor të Kosovës, si dhe një zyrë e specializuar prokurorie do të shfrytëzoheshin për procedurat gjyqësore dhe të apelit që dalin nga hetimet e SITF. [...] procedurat e ndjeshme, duke përfshirë dëgjimin e dëshmitarëve, do të mbaheshin jashtë vendit, [Kosovës] [...] dosjet dhe shkresat e ndjeshme do të paraqiten dhe mbahen ekskluzivisht jashtë vendit [Kosovës].

Për të mundësuar [...] e procedurave të tilla, Kosova do të themelojë dhoma të veçanta e të dedikuara gjyqësore, të cilat do të zhvendosen në një shtet të tretë [...] për çfarëdo procedure penale e cila mund të iniciohet si rezultat i punës së SITF.

Këto struktura do të administrohen me statutin e vet dhe rregulloren e punës dhe të dëshmive, [...]. Të gjitha masat ligjore [...] për themelimin e gjykatës së specializuar [...], si dhe zyrës së prokurorisë së specializuar, në lidhje me SITF [...] duke përfshirë edhe amendamentet kushtetuese sipas nevojës, do të miratohen në pajtim me ligjin në Kosovë, si dhe do t'i nënshtrohen shqyrtimit nga Gjykata Kushtetuese.

---

<sup>14</sup> Ligji nr. 04/L-148 për ratifikimin e marrëveshjes ndërkombëtare mes Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian mbi Misionin e Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë. Më 7 shtator 2012, me Dekretin nr. DL-039-2012, Presidentja e Kosovës shpalli Ligjin nr. 04/L-148. Në të njëjtën ditë, Ligji nr. 04/L-148 hyri në fuqi, në pajtim me nenin 3 të tij.

[...]

Ne do të marrim përsipër, në pajtim me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi në Kosovë, me Shefin e Misionit EULEX KOSOVA dhe/ose PSBE [...] konsultimet në procesin e ndryshim-plotësimit të ligjeve që kanë ndikim në ushtrimin e mandatit të Misionit EULEX KOSOVA, si dhe për procedurat gjyqësore që iniciohen si rezultat i hetimeve nga SITF-ja, si dhe PSBE--së në ushtrimin e mandatit të tij.

[...]

[...] puna dhe mandati i deleguar për të siguruar operimin e dhomave të lartpërmendura gjyqësore dhe prokurorive speciale [...] do të vazhdojë deri në momentin kur Kosova merr njoftimin nga Këshilli i Bashkimit Evropian që hetimet kanë përfunduar, si dhe çdo procedurë nga dhomat gjyqësore që rezultojnë nga ato hetime, të kenë përfunduar.

14. Në letrën e saj drejtuar Presidentes së Kosovës, Përfaqësuesja e Lartë deklaroi si vijon:

[...]

[...] puna e [TFHS-së] dhe çfarëdo procedurash gjyqësore që burojnë nga ajo, do të vazhdojë deri sa Këshilli i Bashkimit Evropian ta njoftojë Kosovën që hetimet dhe procedurat përkatëse janë përmbyllur.

[...]

15. Më 23 prill 2014, me Ligjin nr. 04/L-274, Kuvendi i Kosovës ratifikoi Shkëmbimin e Letrave të përmendur më lart si marrëveshje ndërkombëtare mes Kosovës dhe BE-së. Neni 1(2) i Ligjit përcakton ratifikimin e marrëveshjes ndërkombëtare në tërësi.<sup>15</sup>

#### D. AMENDAMENTI KUSHTETUES

16. Më 7 mars 2015, Qeveria e Kosovës propozoi një amendament të Kushtetutës, përkatësisht që pas nenit 161 të Kushtetutës të shtohet neni i ri 162 për Dhomat e

---

<sup>15</sup> Ligji nr. 04/L-274 për ratifikimin e marrëveshjes ndërkombëtare në mes të Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian mbi Misionin e Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë. Kuvendi i Kosovës miratoi Ligjin nr. 04/L-274 me shumicë prej dy të tretave, në pajtim me nenin 18 të Kushtetutës. Në lidhje me miratimin me shumicë prej dy të tretave, shih Kosovë, Gjykata Kushtetuese, *Vlerësim i amendamentit të Kushtetutës të Republikës së Kosovës, të propozuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës dhe referuar më 9 mars 2015 nga Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës, me Shkresën nr. 05-433/DO-318, KO 26/15, Aktgjykim, 14 prill 2015 (15 prill 2015), para. 51. Më 7 maj 2014, me Dekretin nr. DL-022-2014, Presidentja e Kosovës shpalli Ligjin nr. 04/L-274. Më 15 maj 2014, Ligji nr. 04/L-274 u publikua në Gazetën Zyrtare të Kosovës dhe hyri në fuqi 15 ditë më pas, në përputhje me nenin 3 të tij.*

Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar.<sup>16</sup> Neni 162(1) përcakton se, për “[t]’i përmbushur obligimet ndërkombëtare në lidhje me [Raportin], Republika e Kosovës mund të themelojë Dhoma të Specializuara dhe një Zyrë të Prokurorit të Specializuar [...]”.

17. Më 9 mars 2015, në pajtim me nenet 113(9) dhe 144(3) të Kushtetutës, Kryetari i Kuvendit të Kosovës i referoi Gjykatës Kushtetuese të Kosovës amendamentin e lartpërmendur për vlerësim paraprak se ai nuk pakësonte të drejtat dhe liritë e garantuara në Kapitullin II të Kushtetutës.<sup>17</sup>

18. Më 14 prill 2015,<sup>18</sup> Gjykata Kushtetuese e Kosovës konfirmoi se amendamenti i propozuar nuk pakësonte të drejtat dhe liritë e garantuara me Kapitullin II dhe Kapitullin III të Kushtetutës dhe ishte në pajtim me frymën e me tekstin e saj. Gjykata Kushtetuese theksoi se përfshirja e amendamentit buronte nga Marrëveshja Ndërkombëtare ndërmjet Republikës së Kosovës dhe BE-së e 14 prillit 2014 (shih paragrafët 13-15 më lart).<sup>19</sup>

19. Më 3 gusht 2015, Kuvendi i Kosovës ndryshoi Kushtetutën, duke shtuar pas nenit 161, nenin e ri 162 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar. Ai hyri në fuqi në të njëjtën ditë.

#### E. LIGJI

20. Më 3 gusht 2015, Kuvendi i Kosovës miratoi Ligjin nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar (“Ligji”). Sipas nenit 1(1) të Ligjit, ky Ligj rregullon organizimin, funksionet dhe juridiksionin e Dhomave të Specializuara dhe të ZPS-së.

---

<sup>16</sup> Kosovë, Gjykata Kushtetuese, KO 26/15, cituar më lart, para. 13.

<sup>17</sup> Po aty, para. 1, 14.

<sup>18</sup> Po aty, para. 9-10.

<sup>19</sup> Po aty, para. 37.

21. Më 31 gusht 2015, Ligji u publikua në Gazetën Zyrtare të Kosovës dhe hyri në fuqi 15 ditë më pas, në përputhje me nenin 65 të tij.

#### F. MARRËVESHJA ME SHETIN PRITËS

22. Më 15 shkurt 2016, Kosova nënshkroi marrëveshje me Holandën për vendosjen e selisë së Dhomave të Specializuara dhe Zyrës së Prokurorit të Specializuar në Hagë, në pajtim me nenin 162 të Kushtetutës, Shkëmbimin e Letrave të vitit 2014 dhe Ligjin.

23. Neni 2 i Marrëveshjes përcakton se “ajo [...] krijon kushte të përshtatshme për qëndrueshmërinë dhe pavarësinë e [Dhomave të Specializuara dhe Zyrës së Prokurorit të Specializuar, të zhvendosura në shtetin pritës] dhe mundëson funksionimin e tyre të papenguar dhe efikas”.

24. Marrëveshja hyri në fuqi më 1 janar 2017.

#### G. SHKËMBIME TË TJERA TË LETRAVE

25. Midis viteve 2016 dhe 2020, Presidenti i Kosovës dhe Përfaqësuesi i Lartë shkëmbyen letra të tjera, por asnjëra prej tyre nuk rregullon mandatin e Dhomave të Specializuara dhe ZPS-së.<sup>20</sup>

#### H. AMENDAMENTET KUSHTETUESE TË PROPOZUARA

26. Më 24 gusht 2020, Presidenti i Kosovës propozoi amendamentet nr. 26 dhe nr. 27 të Kushtetutës, në veçanti të nenit të saj 162(13) dhe (14).<sup>21</sup>

---

<sup>20</sup> Më 9 dhe 15 qershor 2016, Presidenti i Kosovës dhe Përfaqësuesja e Lartë shkëmbyen letra në lidhje me mandatin e Misionit EULEX Kosova. Shih Ligji nr. 05/L-102 për ratifikimin e marrëveshjes ndërkombëtare në mes të Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian mbi Misionin e Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë.

Më 4 dhe 8 qershor 2018, Presidenti i Kosovës dhe Përfaqësuesja e Lartë shkëmbyen letra në lidhje me mandatin e Misionit EULEX Kosova.

Më 8 dhe 10 korrik 2020, Presidenti i Kosovës dhe Përfaqësuesi i Lartë shkëmbyen letra në lidhje me mandatin e Misionit EULEX Kosova.

<sup>21</sup> KSC-CC-2020-11, F0001, A01 Propozim-amendamentet e Kushtetutës, publike, 24 gusht 2020 (protokolluar më 21 shtator 2020).



### III. REFERIMI

27. Më 18 shtator 2020, Kryetarja e Kuvendit të Kosovës, duke u mbështetur në nenet 144(3) dhe 162(3) të Kushtetutës, amendamentet kushtetuese të propozuara ia përcolli Kryetares së Dhomave të Specializuara. Në veçanti, Kryetarja e Kuvendit i kërkoi kësaj Dhome që të bënte vlerësim paraprak se amendamentet e propozuara kushtetuese nuk zbehnin ndonjërin nga të drejtat dhe liritë e përcaktuara në Kapitullin II të Kushtetutës. ("Referimi").<sup>22</sup>

### IV. JURIDIKSIONI

28. Dhoma thekson se në pajtim me nenin 162(3) të Kushtetutës dhe nenin 49(2) të Ligjit, kjo Dhomë ka juridiksion ekskluziv mbi referime të cilat, së pari, bëhen në bazë të nenit 113 të Kushtetutës, dhe, së dyti, kanë lidhje me Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar.

29. Për sa i përket kriterit të parë, Dhoma vëren se Kryetarja e Kuvendit e ka bërë referimin në bazë të nenit 144(3) të Kushtetutës, i cili parasheh vlerësim paraprak nga Gjykata Kushtetuese të amendamenteve kushtetuese të propozuara. Vlerësimi paraprak i amendamenteve kushtetuese të propozuara parashihet edhe në nenin 113(9) të Kushtetutës. Nga kjo rrjedh se Referimi është bërë në bazë të nenit 113, përkatësisht paragrafit (9) të tij, si edhe në bazë të nenit 144(3).<sup>23</sup>

---

<sup>22</sup> KSC-CC-2020-11, F00001, Shkresë e Kryetares së Kuvendit të Kosovës, 18 shtator 2020, me shtojcën A01 (protokolluar më 21 shtator 2020).

<sup>23</sup> Në lidhje me këtë, shih Kosovë, Gjykata Kushtetuese, KO 26/15, cituar më lart, para. 1, 4; *Konfirmim i amendamentit të propozuar kushtetues, të paraqitur nga Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës, më 24 tetor 2018, me shkresën nr. 06/2156/DO-1156*, KO 162/18, Aktgjykim, 19 dhjetor 2018 (7 shkurt 2019), para. 4; *Vlerësim i një amendamenti të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të propozuar nga pesëdhjetë e pesë deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës, dhe të referuar nga Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës më 6 shkurt 2015 me shkresën nr. 05-259/DO-179*, KO 13/15, Aktgjykim, 10 mars 2015 (16 mars 2015), para. 1, 4; *Vlerësim i amendamenteve të Kushtetutës të propozuara nga Qeveria, të dorëzuara nga Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës më 11 mars 2014, me shkresën Nr. 04-DO-2186*, KO 44/14, Aktgjykim, 31 mars 2014 (3 prill 2014), para. 2, 5.

30. Për sa i përket kriterit të dytë, Dhoma vëren se amendamentet kushtetuese të propozuara kanë të bëjnë me nenin 162(13) dhe (14) të Kushtetutës. Paragrafi (1) i nenit 162 përcakton se “organizimi, funksionimi dhe juridiksioni i Dhomave të Specializuara dhe i Zyrës së Prokurorit të Specializuar rregullohen me këtë nen [...]”. Nga kjo rrjedh se Referimi është në lidhje me Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar.

31. Rrjedhimisht, Dhoma konstaton se ka juridiksion ekskluziv për të marrë vendim mbi këtë Referim në përputhje me nenin 162(3) të Kushtetutës dhe nenin 49(2) të Ligjit.<sup>24</sup>

## V. PRANUESHMËRIA

### A. PARASHTRIMET

32. Avokati i Popullit i Dhomave të Specializuara dhe Përfaqësuesi i Lartë parashtruan se Referimi është i papranueshëm për arsye se Presidenti i Kosovës kishte propozuar ndryshimet kushtetuese në shkelje të procedurës në fuqi. Ai nuk kishte bërë konsultimet që parashihen në Shkëmbimin e Letrave të vitit 2014 (shih paragrafin 13 më lart) përpara se t’ia kalonte amendamentet kushtetuese Kryetares së Kuvendit.<sup>25</sup>

33. Në mënyrë të ngjashme, edhe Shefi i Misionit EULEX Kosova e konsideron Referimin të papranueshëm. Duke iu referuar rregullës 14(f) të Rregullores, duket se ai argumenton që Referimi përbën shkelje të procesit, duke qenë se Presidenti i Kosovës nuk ishte konsultuar me Misionin EULEX Kosova në lidhje me amendamentet e propozuara. Kriteri i konsultimit buron nga Shkëmbimi i Letrave i

---

<sup>24</sup> Për juridiksionin, shih Kosovë, Gjykata Kushtetuese, KO 26/15, cituar më lart, para. 36 (pika c.), 78.

<sup>25</sup> KSC-CC-2020-11, F00007, Parashtrime të Avokatit të Popullit në lidhje me Referimin, publike, 16 tetor 2020, para. 21-27; KSC-CC-2020-11, F00013, Parashtrim me shkrim nga Përfaqësuesi i Lartë i Bashkimit për Politikën e Jashtme dhe të Sigurisë mbi pranueshmërinë e Referimit, publik, 30 tetor 2020, para. 13-17.

vitit 2014, i përfshirë në nenin 162 të Kushtetutës përmes referencës ndaj Ligjit nr. 04/L-274.<sup>26</sup>

34. ZPS-ja, nga ana tjetër, nuk pretendon se Referimi është i papranueshëm. Ajo thekson se Referimi është parashtruar në përputhje me nenin 113(9) të Kushtetutës.<sup>27</sup>

#### B. VLERËSIMI I DHOMËS

35. Dhoma rithekson se në bazë të nenit 113(1) të Kushtetutës, ajo “vendos vetëm për rastet e ngritura para [saj] në mënyrë të ligjshme nga palë të autorizuar”.<sup>28</sup> Sikurse theksohet më lart, ky Referim bazohet në nenin 113(9), i cili përcakton si vijon:

Kryetari i Kuvendit të Kosovës duhet të referojë amendamentet kushtetuese të propozuara para miratimit në Kuvend, me qëllim që të konstatohet nëse amendamenti i propozuar i zvogëlon të drejtat dhe liritë e garantuara me kapitullin II të Kushtetutës.

36. Në rastin aktual, amendamentet kushtetuese të propozuara i janë referuar Dhomës nga Kryetarja e Kuvendit, e cila është e autorizuar të bëjë këtë bazuar në nenin 113(9). Gjithashtu, Kryetarja e Kuvendit i ka kërkuar Dhomës të bëjë vlerësim paraprak të amendamenteve të propozuara nëse ato pakësojnë të drejtat dhe liritë e përcaktuara në Kapitullin II të Kushtetutës (shih paragrafin 27 më lart). Nga kjo rrjedh se Referimi i plotëson kriteret e nenit 113(1) dhe (9).

37. Për sa i përket argumentit të Avokatit të Popullit dhe Përfaqësuesit të Lartë se procedura e propozimit të ndryshimeve kushtetuese përbën kriter për pranueshmërinë e Referimit, Dhoma thekson se një kriter i tillë për pranueshmërinë nuk përcaktohet në Kushtetutë, në Ligj, ose në Rregullore. Po kështu, Dhoma e ka të vështirë të pranojë argumentin e Shefit të Misionit EULEX Kosova se, për shkak të

---

<sup>26</sup> KSC-CC-2020-11, F00014, Parashtrim me shkrim nga Shefi i Misionit EULEX Kosova, publik, 2 nëntor 2020, para. 12, 14, 17-18.

<sup>27</sup> KSC-CC-2020-11, F00008, Parashtrime të Prokurorisë në lidhje me amendamentet e propozuara të Kushtetutës së Kosovës, publike, 19 tetor 2020, para. 7.

<sup>28</sup> KSC-CC-2020-08, F00020, RED, Version i redaktuar publik i vendimit mbi kërkesën referuese të [REDAKTUAR] në vijim të vendimit të Gjykatësit të Vetëm, publik, 20 prill 2020, para. 38.

mungesës së konsultimeve, Referimi përbën shkelje të procesit sipas rregullës 14(f) të Rregullores. Informacioni që ka Dhoma është i pamjaftueshëm për të treguar se Referimi përfshin ushtrim të dëmshëm të një të drejte për qëllime të tjera nga ato për të cilat është hartuar.<sup>29</sup> Njëkohësisht, Dhoma do t'i kthehet aspektit të konsultimeve kur të vlerësojë themelësinë e Referimit.

38. Në pajtim me sa më lart, Dhoma konstaton se Referimi është bërë në mënyrë të ligjshme nga një palë e autorizuar në bazë të nenit 113(9) të Kushtetutës, dhe rrjedhimisht duhet të shpallet i pranueshëm në pajtim me nenin 113(1) të Kushtetutës.<sup>30</sup>

## VI. VLERËSIMI

### A. NENI 162 I KUSHTETUTËS

39. Në nenin 162(13) dhe (14) të Kushtetutës, në lidhje me të cilin janë amendamentet e propozuara, lexohet si vijon:

#### Neni 162

#### Dhomat e Specializuara dhe Zyra e Prokurorit të Specializuar

Pavarësisht dispozitave tjera të kësaj Kushtetute:

[...]

<sup>29</sup> Në lidhje me këtë, shih ECtHR, *Zhdanov and Others v. Russia*, nos. 12200/08 and 2 others /GJEDNJ, *Zhdanov dhe të tjerë k. Ruisë*, nr. 12200/08 dhe 2 të tjerë, 16 korrik 2019, para. 79; *Miroļubovs and Others v. Latvia /Miroļubovs dhe të tjerë k. Letonisë*, nr. 798/05, 15 shtator 2009, para. 62.

<sup>30</sup> Shih Kosovë, Gjykata Kushtetuese, KO 26/15, cituar më lart, para. 16-21; KO 162/18, cituar më lart, para. 17-21; KO 13/15, cituar më lart, para. 17-22; KO 44/14, cituar më lart, para. 21-22; *Konfirmim i amendamentit të propozuar kushtetues, të paraqitur nga Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës, më 18 janar 2013, nëpërmjet shkresës Nr. 04-DO-1357*, KO 09/13, Aktgjykim, 29 janar 2013, para. 13-15; *Konfirmimi i amendamenteve të propozuara kushtetuese, të paraqitura nga Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës, më 22 qershor 2012, me shkresën Nr. 04-DO-1095*, KO 61/12, Aktgjykim, 31 tetor 2012, para. 14-16; *Amendamentet e propozuara kushtetuese, të dorëzuara nga Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës më 23 mars 2012 dhe 4 maj 2012*, KO 29/12 dhe KO 48/12, Aktgjykim, 20 korrik 2012, para. 34-37; *Vlerësim i kushtetutshmërisë së Propozimeve të Qeverisë për Amendamentimin e Kushtetutës, të dorëzuar nga Kryetari i Kuvendit të Republikës më 12 prill 2012*, KO 38/12, Aktgjykim, 10 mars 2012 (15 maj 2012), para. 20-26.

13. Mandati i Dhomave të Specializuara dhe Zyrës së Prokurorit të Specializuar do të zgjasë për një periudhë pesëvjeçare (5), përveç nëse njoftimi i përfundimit të mandatit në pajtim me Ligjin nr. 04/L-274 bëhet më herët.

14. Në mungesë të njoftimit për përfundim të mandatit sipas paragrafit 12, mandati i Dhomave të Specializuara dhe i Zyrës së Prokurorit të Specializuar do të vazhdojë deri kur njoftimi i përfundimit të mandatit të bëhet në përputhje me Ligjin nr. 04/L-274 dhe në konsultim me Qeverinë.

## B. AMENDAMENTET E PROPOZUARA TË KUSHTETUTËS

40. Në amendamentet kushtetuese të propozuara nga Presidenti i Kosovës, në veçanti nenet 162(13) dhe (14) të saj, lexohet si vijon:

### I.

#### Amendamenti nr. 26

Paragrafi 13 i nenit 162 [Dhomat e Specializuara dhe Zyra e Prokurorit të Specializuar], fshihet dhe riformulohet me tekstin në vijim:

13. Mandati i Dhomave të Specializuara dhe Zyrës së Prokurorit të Specializuar do të zgjasë deri kur njoftimi i përfundimit të mandatit të bëhet nga Këshilli i Bashkimit Evropian, në konsultim me Qeverinë e Republikës së Kosovës.

#### Amendamenti nr. 27

Paragrafi 14 i nenit 162 [Dhomat e Specializuara dhe Zyra e Prokurorit të Specializuar], fshihet.

### II.

Ndryshimet kushtetuese hyjnë në fuqi menjëherë pas miratimit të tyre në Kuvendin e Republikës së Kosovës.

## C. INFORMACIONI I DORËZUAR NGA PRESIDENTI I KOSOVËS

41. Në përgjigje të kërkesës së Dhomës për informacion në lidhje me arsyen për amendamentet kushtetuese të propozuara,<sup>31</sup> Presidenti i Kosovës u shpreh se paragrafët (13) dhe (14) të nenit 162 kanë krijuar paqartësi lidhur me përfundimin e mandatit të Dhomave të Specializuara dhe ZPS-së. Sipas formulimeve të këtyre

---

<sup>31</sup> KSC-CC-2020-11, F00004, Vendim për njoftimin e referimit dhe kërkesë për informacion, publik, 5 tetor 2020.

dispozitave, është shpërfaqur mendimi që mandati i tyre do të zgjasë për një periudhë më së shumti pesëvjeçare, që ka ngjallur reagime të shumta.

42. Rrjedhimisht, amendamentet e propozuara kanë për qëllim të shmangin “këto paqartësi dhe eliminojnë çdo dilemë”. Ato përcaktojnë se mandati i Dhomave të Specializuara dhe ZPS-së do të zgjasë “deri kur njoftimi i përfundimit të mandatit të bëhet nga Këshilli i Bashkimit Evropian, në konsultim me Qeverinë e Republikës së Kosovës”. Pra, amendamenti i propozuar - ka deklaruar Presidenti i Kosovës - është harmonizim i nenit 162 me atë që është përcaktuar në Ligjin nr. 04/L-274.<sup>32</sup>

#### D. PARASHTRIME NGA AUTORITETE TË TJERA

##### 1. Avokati i Popullit i Dhomave të Specializuara

43. Avokati i Popullit parashtron se amendamentet kushtetuese të propozuara do të hiqnin nga neni 162 referencën thelbësore ndaj Ligjit nr. 04/L-274 (shih paragrafin 15 më lart) dhe rrjedhimisht detyrimet ndërkombëtare të Kosovës që burojnë nga Shkëmbimi i Letrave i vitit 2014. Avokati i Popullit argumenton se këto detyrime ndërkombëtare janë kyçe për administrimin e duhur të drejtësisë dhe mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të pjesëmarrësve në proceset para Dhomave të Specializuara dhe Zyrës së Prokurorit të Specializuar.

44. Në veçanti këtu përfshihen aspekte si zhvendosja e Dhomave të Specializuara dhe Zyrës së Prokurorit të Specializuar në një shtet të tretë, punësimi në to vetëm i personelit ndërkombëtar, bartja e të gjitha kompetencave shtetërore të nevojshme për funksionimin e tyre, si dhe vazhdimi i bartjes dhe funksionimit deri kur Këshilli të njoftojë Kosovën për përfundimin e të gjitha proceseve gjyqësore. Avokati i Popullit

---

<sup>32</sup> KSC-CC-2020-11, F00009, Parashtrime të Presidentit të Republikës së Kosovës, publike, 16 tetor 2020 (protokolluar më 19 tetor 2020), f. 7, para. 5-6.

shpreh mendimin se këto detyrime ndërkombëtare nuk duhet të fshihen nga Kushtetuta, e cila është akti juridik më i lartë i Kosovës sipas nenit 16(1) të saj.<sup>33</sup>

## 2. ZPS

45. Edhe ZPS-ja mendon se amendamentet kushtetuese të propozuara do të hiqnin nga Kushtetuta të gjitha referencat konkrete në lidhje me Shkëmbimin e Letrave të vitit 2014. Amendamentet e propozuara gjithashtu do të krijonin pasiguri në lidhje me kohëzgjatjen e mandatit të Dhomave të Specializuara dhe ZPS-së. Kjo pasiguri do të vinte në rrezik një numër të drejtash dhe lirish themelore të garantuara prej Kapitullit II të Kushtetutës, ndër të cilat e drejta për jetë në bazë të nenit 25, e drejta për gjykim të drejtë e të paanshëm në bazë të neneve 30 dhe 31 dhe e drejta për mbrojtjen gjyqësore të të drejtave, në bazë të nenit 54.

46. Në lidhje me pasigurinë që do të krijonin amendamentet kushtetuese të propozuara, ZPS-ja u referohet deklaratave të Presidentit të Kosovës. Në lidhje me amendamentet e propozuara, Presidenti ka deklaruar se ishte e nevojshme të “zgjatej” dhe “qartësohej” mandati i Dhomave të Specializuara dhe ZPS-së. Në veçanti ‘zgjatja’ e mandatit nënkuptonte se mandati tashmë kishte përfunduar. Rrjedhimisht miratimi i amendamenteve të propozuara do të linte derën e çelur për interpretimin e kohëzgjatjes së mandatit të Dhomave të Specializuara dhe ZPS-së. Sidoqoftë, ky mandat përcaktohet qartë në paragrafët (13) dhe (14) të nenit 162 lexuar së bashku me Shkëmbimin e Letrave të vitit 2014.

47. Gjithashtu, ZPS-ja thekson se amendamentet kushtetuese të propozuara, në fakt përmbajnë dy amendamente të veçanta, nr. 26 dhe nr. 27. Rrjedhimisht është e mundshme që të miratohet vetëm njëri prej tyre, pa miratimin e tjetrit. Në rast se do të miratohej vetëm amendamenti i propozuar nr. 27, kohëzgjatja e mandatit të Dhomave të Specializuara dhe ZPS-së do të reduktohej në pesë vjet, afat që tashmë ka

---

<sup>33</sup> KSC-CC-2020-11, F00007, Parashtrime të Avokatit të Popullit në lidhje me Referimin, publike, 16 tetor 2020, para 31-32, 35-36, 40-42, 44.

kaluar. Kjo do të përbënte një shkelje të qartë të të drejtave dhe lirive themelore të garantuara prej Kapitullit II.<sup>34</sup>

## E. VLERËSIMI I DHOMËS

### 1. Fushëveprimi i vlerësimit

48. Fillimisht, Dhoma rikujton se referimi është bërë në bazë të nenit 113(9) të Kushtetutës. Rrjedhimisht, dispozita e sapopërmendur vendos kufijtë për këtë vlerësim.<sup>35</sup> Duke marrë parasysh formulimin e nenit 113(9) (shih paragrafin 35 më lart), pyetja konkrete që duhet të shqyrtojë Dhoma ka të bëjë me të drejtën materiale, veçanërisht nëse amendamentet kushtetuese të propozuara pakësojnë të drejtat dhe liritë e garantuara prej Kapitullit II.

49. Duke qenë se neni 113(9) parasheh vlerësimin e amendamenteve kushtetuese të propozuara sa u përket të drejtave dhe lirive të garantuara prej Kapitullit II, lind pyetja nëse Dhoma duhet ta kryejë këtë vlerësim vetëm duke iu referuar Kapitullit II. Në lidhje me këtë, Dhoma vëren se Gjykata Kushtetuese e Kosovës në vlerësimin e amendamentit që paraqiti nenin 162, krahas të drejtave dhe lirive të garantuara prej Kushtetutës, iu referua edhe frymës e tekstit të Kushtetutës.<sup>36</sup> Gjykata Kushtetuese ka përdorur një qasje të ngjashme edhe në raste të tjera për vlerësimin e amendamenteve të propozuara kushtetuese sipas nenit 113(9) të Kushtetutës.<sup>37</sup>

50. Duke mbajtur parasysh sa më lart, Dhoma do ta kryejë vlerësimin e amendamenteve kushtetuese të propozuara duke iu referuar Kapitullit II të

---

<sup>34</sup> KSC-CC-2020-11, F00008, Parashtrime të Prokurorisë në lidhje me amendamentet e propozuara të Kushtetutës së Kosovës, publike, 19 tetor 2020, para 8-13, 16-21.

<sup>35</sup> Sa i përket kompetencës juridikionale në bazë të nenit 113(9) të Kushtetutës, shih Kosovë, Gjykata Kushtetuese, KO 29/12 dhe KO 48/12, cituar më lart, para. 59.

<sup>36</sup> Kosovë, Gjykata Kushtetuese, KO 26/15, cituar më lart, para. 22.

<sup>37</sup> Shih Kosovë, Gjykata Kushtetuese, KO 162/18, cituar më lart, para. 24-25, 27, 49; KO 13/15, cituar më lart, para. 23-24; KO 44/14, cituar më lart, para. 25-28; KO 09/13, cituar më lart, para. 17; KO 61/12, cituar më lart, para. 18; KO 29/12 dhe KO 48/12, cituar më lart, para. 61-64, 68-70; KO 38/12, cituar më lart, para. 31.



Kushtetutës dhe dispozitave të tjera relevante të saj që garantojnë të drejtat dhe liritë themelore dhe duke mbajtur parasysh si duhet Kushtetutën në tërësi.

51. Në këtë pikë, Dhoma gjithashtu rikujton se në bazë të nenit 53 të Kushtetutës, ajo duhet të interpretojë të drejtat njerëzore dhe liritë themelore të garantuara prej Kapitullit II të Kushtetutës, në pajtim me vendimet e Gjykatës Evropiane për Të Drejtat e Njeriut (“GJEDNJ”).<sup>38</sup>

52. Duke mbajtur parasysh sa më lart, Dhoma do të shqyrtojë në bazë të nenit 113(9) të Kushtetutës pyetjen që i është parashtruar nëse amendamentet kushtetuese të propozuara pakësojnë ose nuk pakësojnë të drejtat dhe liritë themelore.

## **2. A i pakësojnë amendamentet e propozuara të drejtat dhe liritë themelore**

53. Fillimisht, Dhoma thekson se domethënia e vërtetë e amendamenteve kushtetuese të propozuara për sa u përket të drejtave dhe lirive themelore, mund të përcaktohet vetëm duke marrë parasysh kontekstin dhe qëllimin specifik të Dhomave të Specializuara dhe ZPS-së, dhe veçoritë specifike të kornizës së tyre ligjore.<sup>39</sup>

---

<sup>38</sup> Shih KSC-CC-2019-05, F00012, Vendim mbi Referimin e Mahir Hasanit në lidhje me Urdhrin e Prokurorisë të 20 dhjetorit 2018, publik, 20 shkurt 2019, para. 25; KSC-CC-PR-2020-09, F00006, Aktvendim mbi referimin e ndryshimeve të Rregullores së Procedurës dhe të Provave të miratuara nga Plenarja më 29 dhe 30 prill 2020, publik, 22 maj 2020, para. 16; KSC-CC-PR-2017-01, F00004, Aktvendim mbi referimin e ndryshimeve të Rregullores së Procedurës dhe të Provave të miratuara nga Plenarja më 17 mars 2017 drejtuar Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese, publik, 26 prill 2017, para. 16 në fund. Shih gjithashtu Kosovë, Gjykata Kushtetuese, *Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Pml nr. 181/15 të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës të 6 nëntorit 2015*, KI 43/16, Aktvendim për papranueshmëri, 14 prill 2016 (16 maj 2016), para. 50 në fund; *Gëzim dhe Makfire Kastrati kundër Gjykatës Komunale në Prishtinë dhe Këshillit Gjyqësor të Kosovës*, KI 41/12, Aktgjykim, 25 janar 2013 (26 shkurt 2013), para. 58.

<sup>39</sup> Më parë Dhoma i është referuar ekzistencës së sistemit ligjor të Dhomave të Specializuara dhe ZPS-së, shih KSC-CC-2019-07, F00013, Vendim mbi kërkesën referuese të Driton Lajçit në lidhje me procedurën e marrjes në pyetje nga Zyra e Prokurorit të Specializuar, publik, 13 janar 2020, para. 32.

## (a) Konteksti dhe qëllimi

54. Dhoma rikujton se Dhomat e Specializuara dhe ZPS-ja u themeluan në lidhje me Raportin (shih paragrafët 9-10, 13 dhe 16 më lart),<sup>40</sup> i cili përmban pretendime të rënda të trajtimit çnjerëzor dhe vrasjes së personave gjatë dhe pas konfliktit të armatosur në Kosovë. Gjithashtu aty përmenden një sërë pengesash në zbulimin e së vërtetës mbi këto ngjarje. Këtu përfshihen hezitimi ose frika e dëshmitarëve për të dëshmuar, mungesa e besimit prej tyre në masat mbrojtëse, si edhe eliminimi. Në Raport pretendohet edhe se personat e përfshirë në veprimet kriminale të pretenduara, më pas morën pozita me pushtet ose janë afër atyre që kanë pushtet, dhe përmenden me emra individë konkretë. Gjithashtu, në Raport theksohen lidhjet midis krimit të organizuar të pretenduar dhe politikës, ku përfshihen edhe përfaqësues të pushtetit.<sup>41</sup>

55. Dhoma nuk mund të anashkalojë faktin se ky është pikërisht konteksti në të cilin Shkëmbimi i Letrave i vitit 2014 parashihte themelimin e Dhomave të Specializuara dhe të ZPS-së për të garantuar administrimin e duhur të drejtësisë në lidhje me proceset që do të rezultonin prej hetimeve të TFHS-së. Faktikisht neni 1(2) i Ligjit i referohet themelimit të Dhomave të Specializuara dhe ZPS-së “për garantimin e procedurave penale të sigurta, të pavarura, të paanshme, të drejta dhe efikase në lidhje me pretendimet [...], të cilat ndërlidhen me ato që janë raportuar në [Raport] dhe të cilat kanë qenë objekt i hetimeve penale të kryera nga [TFHS] [...]”.

56. Prej kësaj rrjedh se arsyeja e ekzistencës së Dhomave të Specializuara dhe ZPS-së dhe, si rrjedhojë, i kornizës së tyre ligjore, është që në kontekstin e tyre specifik të

---

<sup>40</sup> Shih gjithashtu nenin 1(2) të Ligjit ku përcaktohet se “Dhomat e specializuara [...] dhe Zyra e Prokurorit të specializuar janë të domosdoshme për [...] garantimin e procedurave në lidhje me pretendimet [...] të cilat ndërlidhen me ato që janë raportuar në [Raport] [...]”. Gjithashtu, Gjykata Kushtetuese e Kosovës në rastin nr. KO 26/15 deklaroi se themelimi i Dhomave të Specializuara dhe Zyrës së Prokurorit të Specializuar ishte i domosdoshëm me qëllim që Kosova të përmbushte obligimet e veta që buronin prej Raportit. Shih Kosovë, Gjykata Kushtetuese, KO 26/15, cituar më lart, para. 50-53.

<sup>41</sup> Shih Raportin, Pjesa B. Memorandum shpjegues, para. 7, 21, 25, 61, 68-69, 72, 74, 76, 104, 113-114, 172, 176.

realizojnë të drejtat dhe liritë themelore përkatëse lidhur me pretendimet e Raportit dhe në veçanti lidhur me proceset gjyqësore që burojnë prej hetimeve përkatëse të TFHS-së. Amendamentet kushtetuese të propozuara kanë të bëjnë me këtë kornizë ligjore, duke qenë se në to propozohet ndryshimi i nenit 162(13) dhe (14) të Kushtetutës që mbulon aspektet që kanë lidhje me Dhomat e Specializuara dhe ZPS-në.

57. Si pasojë, lipset një analizë tejet e imtësishme dhe e kujdesshme e amendamenteve kushtetuese të propozuara, duke u kushtuar vëmendjen e duhur veçorive specifike të kornizës ligjore të Dhomave të Specializuara dhe ZPS-së.

(b) Veçoritë specifike

58. Prej kontekstit të themelimit të Dhomave të Specializuara dhe ZPS-së del se veçoritë specifike të kornizës ligjore të tyre mundësojnë që, në kontekstin e tyre specifik, Dhomat e Specializuara dhe ZPS-ja të realizojnë “administrimin e duhur të drejtësisë” në lidhje me proceset që burojnë prej hetimeve të TFHS-së, sikurse parashihet në Shkëmbimin e Letrave të vitit 2014.

59. Në lidhje me këtë pikë dhe në kuadër të këtij vlerësimi, Dhoma i referohet bartjes prej Kosovës të disa kompetencave sovrane specifike për funksionimin e Dhomave të Specializuara dhe të ZPS-së në bazë të Shkëmbimit të Letrave të vitit 2014. Në fakt, Shkëmbimi i Letrave i vitit 2014 i referohet nenit 20(1) të Kushtetutës në të cilin përcaktohet se “Republika e Kosovës, në bazë të marrëveshjeve të ratifikuara ndërkombëtare, për çështje të caktuara mund t’u kalojë kompetenca shtetërore organizatave ndërkombëtare”. Gjithashtu mandati i bartur në bazë të Shkëmbimit të Letrave të vitit 2014 vazhdon deri kur Këshilli të njoftojë Kosovën për përfundimin e mandatit.

60. Krahas bartjes së lartpërmendur të kompetencave sovrane specifike, Shkëmbimi i Letrave i vitit 2014 parashihte që Dhomat e Specializuara dhe ZPS-ja do të kishin

kornizën e tyre ligjore. Në veçanti, në Shkëmbimin e Letrave të vitit 2014 pohohet që Dhomat e Specializuara dhe ZPS-ja “do të administrohen me statutin e vet dhe rregulloren e punës dhe dëshmive [...]”. Për më tepër, Kosova u zotua që të miratonte legjislacionin për funksionimin e Dhomave të Specializuara dhe ZPS-së, duke përfshirë “çfarëdo amendamentesh kushtetuese të nevojshme”.

61. Në lidhje me këtë, Dhoma konstaton se Kosova e përmbushi obligimin për miratimin e legjislacionit për funksionimin e Dhomave të Specializuara dhe ZPS-së nëpërmjet miratimit të nenit 162 të Kushtetutës dhe miratimit të Ligjit. Sa i përket këtij aspekti, Dhoma mbështet mendimin e Gjykatës Kushtetuese të Kosovës se përfshirja e nenit 162 të Kushtetutës lidhur me Dhomat e Specializuara dhe ZPS-në ishte rrjedhojë e Shkëmbimit të Letrave të vitit 2014 (shih paragrafin 18 më lart).

62. Lidhur me kornizën ligjore të Dhomave të Specializuara dhe ZPS-së, Dhoma vëren se kjo veçori pasqyrohet edhe në nenin 162(1) të Kushtetutës ku shkruhet se “organizimi, funksionimi dhe juridiksioni i Dhomave të specializuara dhe i Zyrës së Prokurorit të specializuar rregullohen me këtë nen dhe [Ligj]”. Për më tepër, neni 162 për Dhomat e Specializuara dhe ZPS-në zbatohet “pavarësisht dispozitave të tjera të kësaj Kushtetute”. Gjithashtu, neni 3(4) i Ligjit përcakton se “çdo ligj, rregullore, rregullore dytësore, rregull ose zakon tjetër dhe praktikë e Kosovës, që nuk janë përfshirë shprehimisht në këtë ligj, nuk zbatohen për organizimin, administrimin, funksionet apo juridiksionin e Dhomave të Specializuara dhe Zyrës së Prokurorit të Specializuar [...]”.

63. Nga veçoritë e Dhomave të Specializuara dhe ZPS-së të parapara në Shkëmbimin e Letrave të vitit 2014 dhe duke mbajtur parasysh “administrimin e duhur të drejtësisë, del qartë se synimi i këtij Shkëmbimi të Letrave ishte që Dhomat e Specializuara dhe ZPS-ja të funksiononin në mënyrë autonome. Një rrjedhim tjetër është që funksionimi në mënyrë autonome sigurohet kryesisht përmes bartjes së disa kompetencave sovrane për aq kohë sa zgjat mandati, çka sjell edhe krijimin e kornizës së tyre ligjore.

(c) Amendamentet kushtetuese të propozuara

(i) Kohëzgjatja e mandatit

64. Në këtë prizëm, Dhoma fillimisht vëren se amendamentet kushtetuese të propozuara ngrenë parimisht temën e autonomisë, si edhe të sigurisë juridike e cila përfshin aspektin e qëndrueshmërisë së kornizës ligjore të Dhomave të Specializuara dhe ZPS-së për sa kohë zgjat mandati i bartur në bazë të Shkëmbimit të Letrave të vitit 2014.<sup>42</sup> Konkretisht, Dhoma thekson se Presidenti i Kosovës i ka propozuar amendamentet në një kohë që Këshilli nuk ka dhënë asnjë njoftim për përfundimin e mandatit në pajtim me Shkëmbimin e Letrave të vitit 2014 dhe nenin 162(13) dhe (14) të Kushtetutës.

65. Në lidhje me këtë pikë, Presidenti i Kosovës iu referua “paqartësisë” në nenin 162(13) dhe (14), që mund të nënkuptonte se mandati i Dhomave të Specializuara dhe ZPS-së ishte i kufizuar për një periudhë pesëvjeçare e cila tashmë kishte përfunduar. Sidoqoftë, Dhoma nuk mund të gjejë një interpretim të tillë të mundshëm për këto dispozita.

66. Në nenin 162(13) dhe (14) përcaktohet se në rast se nuk ka njoftim prej Këshillit për përfundimin e mandatit para përfundimit të periudhës fillestare pesëvjeçare, mandati vazhdon pas periudhës fillestare pesëvjeçare deri kur Këshilli të njoftojë Kosovën për përfundimin e mandatit. Nuk ka pasur asnjë njoftim prej Këshillit për përfundimin e mandatit para përfundimit të periudhës pesëvjeçare fillestare në bazë të nenit 162(13). Rrjedhimisht, mandati i Dhomave të Specializuara dhe i ZPS-së ka vazhduar dhe do të vazhdojë deri në njoftimin prej Këshillit për përfundimin e mandatit sipas nenit 162(14).

---

<sup>42</sup> Duhet theksuar se në lidhje me formulimin e tanishëm të paragrafëve (13) dhe (14) të nenit 162 të Kushtetutës, Gjykata Kushtetuese deklaroi se “ky është në pajtueshmëri me parimin e sigurisë juridike.” Shih Kosovë, Gjykata Kushtetuese, KO 26/15, cituar më lart, para. 101.

67. Vazhdimi i mandatit të Dhomave të Specializuara dhe ZPS-së gjithashtu është në pajtim me Shkëmbimin e Letrave të vitit 2014 të cilit i referohet neni 162(13) dhe (14) në formulimin e vet të tanishëm. Për më tepër, Shkëmbimi i Letrave i vitit 2014 saktëson se çfarë do të thotë përfundimi i mandatit. Në veçanti, aty saktësohet se mandati “do të vazhdojë deri në momentin kur [...] Kosova merr njoftimin nga Këshilli i Bashkimit Evropian që hetimet kanë përfunduar si dhe çdo procedurë nga dhomat gjyqësore që rezultojnë nga ato hetime, të kenë përfunduar”. (theksimi i shtuar)

68. Duke qenë se amendamentet kushtetuese të propozuara sugjerojnë fshirjen nga neni 162(13) dhe (14) i Kushtetutës, të referencës ndaj Shkëmbimit të Letrave të vitit 2014, Dhoma thekson se referenca në fjalë saktëson se mandati i Dhomave të Specializuara dhe ZPS-së vazhdon deri në përfundimin e proceseve gjyqësore përkatëse. Saktësimi në Kushtetutë në lidhje me kohëzgjatjen e mandatit të Dhomave të Specializuara dhe ZPS-së garanton funksionimin e tyre të pandërprerë në mënyrë të sigurt, të pavarur, të paanshme, të drejtë dhe efikase deri në përfundimin e proceseve gjyqësore përkatëse që rezultojnë nga hetimet e TFHS-së.

69. Rrjedhimisht, fshirja e kësaj reference – propozuar në amendamentet nr. 26 dhe nr. 27 – do të pakësonte të drejtat dhe liritë themelore të personave të përfshirë në procese gjyqësore. Lidhur me viktimat, Dhoma i referohet konkretisht, por jo në mënyrë shteruese – të drejtës për hetim të pavarur dhe të efektshëm në bazë të garancive procedurale të neneve 25 dhe 27 të Kushtetutës dhe neneve 2 dhe 3 të Konventës<sup>43</sup>, kurse lidhur me dëshmitarët e mbrojtur, nëse është rasti – të drejtës së respektimit të integritetit fizik dhe psikik sipas nenit 26 të Kushtetutës dhe nenit 8 të Konventës.

70. Përfundimi i lartpërmendur lidhur me amendamentet nr. 26 dhe nr. 27 nxirret pavarësisht nga çka duket se është një gabim teknik në nenin 162(14) kur përmendet njoftimi prej Këshillit i përfundimit të hershëm të mandatit sipas “paragrafit 12”. Me

---

<sup>43</sup> Termi “Konventë” i referohet Konventës Evropiane për Të Drejtat e Njeriut.

këtë njoftim ka të bëjë paragrafi 13, jo paragrafi 12. Rrjedhimisht, “paragrafi 12” në nenin 162(14) duhet të interpretohet si referencë për paragrafin 13. Sido që të jetë, edhe për këtë pikë nuk ka paqartësi.

(ii) Konsultimet

71. Në lidhje me mënyrën si janë propozuar amendamentet kushtetuese nr. 26 dhe nr. 27, Dhoma nuk duhet të lerë jashtë vëmendjes së vet faktin se në Shkëmbimin e Letrave të vitit 2014 përcaktohet kriteri që Kosova të mbajë konsultime me autoritetet përkatëse të BE-së gjatë procesit të ndryshimit të legjislacionit të Kosovës që ka ndikim në procedurat gjyqësore të iniciuara si rezultat i hetimeve të TFHS-së (shih paragrafin 13 më lart).

72. Del se Kosova nuk i ka mbajtur këto konsultime lidhur me amendamentet kushtetuese të propozuara. Dhoma është e vetëdijshme se kjo përbën mangësi procedurale, mirëpo vlerësimi i Dhomës në lidhje me këtë rast nuk është thjesht vlerësim i procedurës.<sup>44</sup> Sipas nenit 113(9) të Kushtetutës, vlerësimi i saj ka të bëjë me një pyetje të së drejtës materiale, nëse amendamentet e propozuara pakësojnë të drejtat dhe liritë themelore (shih paragrafin 48 më lart).<sup>45</sup>

73. Në të njëjtën kohë, neni 162(13) dhe (14) në formulimin e tanishëm përfshin obligimin e mbajtjes së konsultimeve përmes referencës ndaj Ligjit nr. 04/L-274, në nivel kushtetues. Këto dispozita, jo vetëm që i referohen “përfundimit të mandatit”, por edhe më përgjithësisht e specifikojnë mandatin përmes referencës ndaj Ligjit nr. 04/L-274. Rrjedhimisht, obligimi i mbajtjes së konsultimeve i shprehur në Shkëmbimin e Letrave të vitit 2014, është gjithashtu një kriter kushtetues relevant në procesin

---

<sup>44</sup> Për krahasim, në lidhje me vlerësimin e aspekteve procedurale sipas nenit 113(5) të Kushtetutës, shih Kosovë, Gjykata Kushtetuese, *Vlerësim i kushtetutshmërisë së Vendimit nr. 05-V-139 të Kuvendit të Republikës së Kosovës për miratimin e Amendamentit XXIV të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, miratuar më 3 gusht 2015*, KO 107/15, 8 shtator 2015 (21 shtator 2015), para 6, 56, 59, 91 et seq.

<sup>45</sup> Shih Kosovë, Gjykata Kushtetuese, KO 162/18, cituar më lart, para. 2; KO 13/15, cituar më lart, para. 2.

legjislativ të Kosovës.<sup>46</sup> Karakteri kushtetues i këtij kriteri është i rëndësishëm. Si ilustrim, gjatë vlerësimit kushtetues të një procedure të ndjekur për miratimin e ligjeve, procedura në fjalë vlerësohet për pajtueshmërinë e saj me kriteret kushtetuese përkatëse.<sup>47</sup>

74. Është e vërtetë se kriteri i mbajtjes së konsultimeve në procesin e ndryshimit të legjislacionit të Kosovës sikur e kufizon në njëfarë mënyre ushtrimin e kompetencave ligjvënëse të autoriteteve vendore. Gjithsesi, një kufizim i tillë është në pajtim me bartjen e kompetencave sovrane specifike për funksionimin e Dhomave të Specializuara dhe ZPS-së sipas Shkëmbimit të Letrave të vitit 2014.<sup>48</sup> Për më tepër, kriteri i konsultimeve garanton funksionimin e pavarur, të efektshëm dhe të sigurt të Dhomave të Specializuara dhe ZPS-së.

75. Rrjedhimisht fshirja e këtij kriteri nga neni 162 i Kushtetutës – si pasojë e amendamenteve të propozuara nr. 26 dhe nr. 27 – do të pakësonte të drejtat dhe liritë themelore të personave të përfshirë në proceset gjyqësore. Lidhur me viktimat, Dhoma i referohet konkretisht por jo në mënyrë joshteruese – të drejtës për hetim të pavarur dhe të efektshëm në bazë të garancive procedurale të neneve 25 dhe 27 të Kushtetutës dhe neneve 2 dhe 3 të Konventës, ndërsa lidhur me dëshmitarët e mbrojtur, nëse është rasti – të drejtës për respektimin e integritetit fizik dhe psikik në bazë të nenit 26 të Kushtetutës dhe nenit 8 të Konventës.

---

<sup>46</sup> Në jurisprudencën e saj, Gjykata Kushtetuese e Kosovës ka theksuar se në rendin juridik të Kosovës, Kushtetuta është akti më i lartë juridik. Shih Kosovë, Gjykata Kushtetuese, KO 162/18, cituar më lart, para. 23; KO 44/14, cituar më lart, para. 24.

<sup>47</sup> Shih Kosovë, Gjykata Kushtetuese, *Vlerësim kushtetues i Ligjit nr. 04/L-199, për ratifikimin e Marrëveshjes së parë ndërkombëtare të parimeve që rregullojnë normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë dhe të Planit të zbatimit për këtë marrëveshje*, KO 95/13, Aktgjykim, 2 shtator 2013 (9 shtator 2013), para. 72.

<sup>48</sup> Kjo dëshmohet për shembull prej nenit 162(5) të Kushtetutës ku përcaktohet se Dhomat e Specializuara hyjnë në marrëveshje ndërkombëtare për bashkëpunim juridik.



### 3. Përfundim tërësor

76. Duke marrë parasysh sa më lart dhe në pajtim me nenet 113(9) dhe 144(3) të Kushtetutës, Dhoma arrin në përfundimin se në kontekstin specifik të Dhomave të Specializuara dhe ZPS-së, amendamentet kushtetuese të propozuara nr. 26 dhe nr. 27 pakësojnë të drejtat dhe liritë themelore të garantuara prej Kapitullit II të Kushtetutës.

77. Dhoma shton se përmendja në vlerësimin e saj, të disa veçorive specifike të kornizës ligjore të Dhomave të Specializuara dhe ZPS-së nuk përjashton veçoritë e tjera të kësaj kornize ligjore. Po ashtu, përmendja prej Dhomës e disa prej të drejtave dhe lirive themelore nuk përjashton rëndësinë e të drejtave dhe lirive të tjera në lidhje me funksionimin e Dhomave të Specializuara dhe ZPS-së në pajtim me kriteret e Kapitullit II të Kushtetutës.

78. Më tej, Dhoma rithekson se në bazë të nenit 112(1) të Kushtetutës dhe nenit 49(1) të Ligjit, kjo Dhomë është autoriteti përfundimtar për interpretimin e Kushtetutës në lidhje me Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar.

79. Gjithashtu, në bazë të nenit 116(1) të Kushtetutës, ky aktgjykim është detyrues për gjyqësorin dhe të gjithë personat dhe institucionet e Kosovës.<sup>49</sup>

PËR KËTO ARSYE,

Dhoma e Specializuar e Gjykatës Kushtetuese, njëzëri,

1. *E shpall* Referimin e parashtruar nga Kryetarja e Kuvendit të Kosovës, të pranueshëm;

---

<sup>49</sup> Në lidhje me efektin detyrues sipas nenit 116(1) të Kushtetutës, edhe të aktgjyqimeve që vlerësojnë kushtetutshmërinë e amendamenteve të propozuara, shih Kosovë, Gjykata Kushtetuese, KO 29/12 dhe KO 48/12, cituar më lart, para. 71.

2. *Nxjerr përfundimin* se amendamentet kushtetuese nr. 26 dh nr. 27, të propozuara nga Presidenti i Kosovës më 24 gusht 2020, pakësojnë të drejtat dhe liritë e garantuara prej Kapitullit II të Kushtetutës.

\_\_\_\_\_  
/nënshkrimi/

**Vidar Stensland**  
**Kryegjykatës**

Hartuar në anglishte të enjten, 26 nëntor 2020

Në Hagë, Holandë